



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 237, datë 20.4.2022

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.737,
DATË 13.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN
E QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM (QKEDH)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin të Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- I. Në vendimin nr.737, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Në pikat 1, 6, 7, shkronjat “b” e “gj”, dhe 12, emërtimi “Kryeministri”, zëvendësohet me “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.
 2. Në pikën 4, hiqen fjalët “... miratuar me vendimin nr.930, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave.”.
 3. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:
 - a) Në shkronjën “ç” hiqen fjalët “... por jo vetëm ...”;
 - b) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Koordinon planin e veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse;”.

c) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Informon, sa herë që kërkohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, për çështje në zbatim të ushtrimit të kompetencave të saj.”.

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

- a) Në shkronjën “dh” hiqen fjalët “... dhe porosi, me shkrim ose verbale ...”;
- b) Në shkronjën “e”, pas fjalës “... të nevojshme, ...” shtohen fjalët “... pas marrjes së miratimit të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ...”.

5. Në pikën 8, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “... me propozimin e ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 2184/1
DATË 21.4 2022

MINISTRISË SË BRENDSHME
QENDRËS SË KOORDINIMIT KUNDËR
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

